



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1341/1Prot.

Tiranë, më 01/10/2018

**V E N D I M**

**Nr. 191, Datë 01/10/2018**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 104, datë 13.07.2018, e Z. E.C., ku pretendohet diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”, nga ana e Bankës Intesa San Paolo Albania sh.a., në Shqipëri.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se ankuesi punon prej 12 vitesh pranë Bankës Veneto, në Shqipëri. Së fundi, ankuesi është informuar me e-mailin e datës 08.06.2018, të Këshillit të Punëmarrësve të Bankës Veneto, se si rrjedhim i shkrirjes së kësaj banke me Bankën Intesa San Paolo Albania sh.a., rreth 43 punonjës të Bankës Veneto, janë bërë pjesë e një liste për t’u larguar nga puna. Nëpërmjet e-mailit të mësipërm, ankuesi është gjithashtu pjesë e kësaj liste.

Z. E.C. e informoi Komisionerin mbi faktin se procesi i bashkimit të dy bankave të sipërpërmendura ka sjellë një përfitim prej 35 miliard eurosh për Bankën Intesa San Paolo, 4

---

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

miliard prej të cilave janë të destinuara për efekte sociale të tilla si: pensione të parakohshme, lëvizje të brendshme të stafit, etj. Njëkohësisht, ky proces bashkimi në Itali u pasua nga deklarata zyrtare me mediat italiane, të bëra publike në faqen zyrtare të Bankës Intesa San Paolo duke siguruar se punonjësit e Grupit Veneto nuk do të largoheshin nga puna pa një proces vullnetar dëmshpërblimi. Z. E.C. pretendon se është informuar me e-mail të Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës Veneto, Z. P.C., se nuk do të ketë largim nga puna të punonjësve shqiptarë të Bankës Veneto në Shqipëri, si pasojë e procesit të bashkimit/shkrirjes së dy bankave.

Z. E.C. thekson faktin se në kushtet, kur është informuar për listën emërore të punonjësve të Bankës Veneto, që do të largohen nga puna si pasojë e bashkimit të saj me Bankën Intesa San Paolo, ndërkohë që nga titullarët e Bankës Veneto është dhënë konfirmim për të kundërtën, për sqarimin e kësaj çështjeje i është drejtuar zyrtarisht në datën 05.07.2018, Znj. Entela Zigori, Drejtore e Burimeve Njerëzore pranë Bankës Intesa San Paolo. Znj. Ziguri nuk ka dërguar përgjigje në adresë të ankuesit<sup>2</sup>.

Në këto kushte, kur për punonjësit e Bankës Veneto në Itali është zbatuar një standard i ndryshëm, krahasuar me punonjësit shqiptarë të kësaj banke në Shqipëri, në kushtet e bashkimit të bankave Veneto dhe Intesa San Paolo, ankuesi pretendon se ai në cilësinë e punonjësit shqiptar të Bankës Veneto, po diskriminohet për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë. Ankuesi shprehet se e ka të nevojshme vendin e punës pasi është kredimarrës pranë Veneto Banca sh.a., si dhe babai i tij është invalid.

## **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Fillimisht, strukturat përkatëse të Komisionerit kontaktuan me e-mail në datën 18.07.2018 me ankuesin, duke i kërkuar të dhëna të mëtejshme, lidhur me ankesën e depozituar pranë KMD-së. Në vijim, ankuesi paraqiti pranë Komisionerit, dokumentacionin e kërkuar<sup>3</sup>.
- B.** Në vijim të dërgimit të informacionit plotësues nga Z. E.C., pas analizimit të ankesës nr. 71, datë 22.05.2018, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga

---

<sup>2</sup> Çështja e moskthimit përgjigje nga ana e ISPB sh.a. është objekt shqyrtimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale sipas informacionit verbal të dhënë nga ankuesi.

<sup>3</sup> Në këtë dokumentacion nuk bënte pjesë njoftimi për zgjidhje të kontratës së punës nga ana e Intesa San Paolo Bank, i cili ishte pjesë e kërkesës për informacion të KMD-së. Pavarësisht këtij fakti, KMD inicioi hetim administrativ, duke patur parasysh faktin se në kuadër të procesit që po ndodhte, ky njoftim do të paraqitej pranë ankuesit në ditët në vijim.

Diskriminimi”.Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

C. Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>4</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Z. Silvio Pedrazzi, CEO i Bankës Intesa San Paolo dhe për dijeni ankuesit, me shkresën nr. 975/1, datë 18.07.2018, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjet e parashtruara, si më poshtë:

- Informacion, nëse do të ketë largime nga puna të punonjësve shqiptarë të Bankës Veneto, në Shqipëri, si pasojë e bashkimit/shkrirjes së kësaj të fundit me Bankën Intesa San Paolo.
- Nëse po, kërkohet informacion mbi aktin, ku është parashikuar shkurtimi i punonjësve, numri i tyre, mënyrën se si do të kryhet ristrukturimi, si dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve të Bankës Veneto, kontrata e punës së të cilëve do të zgjidhet. Cilat parashikime ligjore, përveç dispozitave të Kodit të Punës, do të zbatohen për dëmshpërblimin e tyre.
- Informacion nëse ankuesi bën pjesë në grupin e punëmarrësve të Bankës Veneto, të cilët do të largohen nga puna, si pasojë e bashkimit të saj me Bankën Intesa San Paolo;
- Informacion i hollësishëm mbi mënyrën, se si është vepruar me punonjësit e Bankës Veneto në Itali, pas bashkimit të saj me Bankën Intesa San Paolo. Në këtë kontekst, nëse ka patur shkurtime të vendeve të punës, të sqarohet se si është vepruar me punonjësit e larguar.
- Informacion mbi “Fondin e Solidaritetit” dhe mënyrat e parashikuara për përdorimin e tij. Si ka shërbyer dhe është përdorur një fond i tillë për punonjësit e Bankës Veneto, në Itali?
- Informacion, nëse “Fondi i Solidaritetit” ekziston edhe në Shqipëri. Nëse po, të përcillet akti administrativ, ku është parashikuar krijimi i një fondi të tillë.
- Kopje e aktit, ku është vendosur bashkimi/shkrirja e Bankës Veneto dhe Bankës Intesa San Paolo.

---

<sup>4</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 975/1, datë 18.07.2018, së Komisionerit, Banka Intesa San Paolo Albania sh.a. (ISPB sh.a.) dërgoi shkresën nr. 271/HR, datë 07.08.2018, nëpërmjet së cilës e bën me dije Komisionerin se në datën 26.06.2017, në vijim të likujdimit të detyrueshëm administrativ të Veneto Banca në Itali, Intesa San Paolo SpA bleu disa aktive, detyrime dhe marrëdhënie juridike të Veneto Banca, duke përfshirë ndër të tjera edhe Veneto Banka sh.a. Aksionet e Veneto Banca në Veneto Banca sh.a. iu shitën Intesa San Paolo SpA, në pritje të kërkesës për autorizim që i është paraqitur Bankës së Shqipërisë në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Në bazë të Vendimit nr. 63, datë 01.11.2017, Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë dha miratimin paraprak për blerjen 100% të kapitalit aksioner të Veneto Banca sh.a. nga Intesa San Paolo (ISP) SpA. Në datën 01.12.2017 është kryer regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) i transferimit të aksioneve të Veneto Banca në ISP SpA.

Në datën 04.05.2018, në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Veneto Banca sh.a. dhe ISBA sh.a. u mor vendimi dhe u miratua projekti i “bashkimit me përthithje” të Veneto Banka sh.a. (Shoqëria e përthithur) me Intesa San Paolo Bank Albania (ISBA) sh.a. ISBA (shoqëria përthithëse) duke parashtruar arsyetimin e hollësishëm dhe të detajuar në Ankesin 1 – Raporti i Bashkimit të Grupit ISP për Shqipërinë, ISP Albania – Veneto Banca. Ky dokument është dërguar pranë QKB dhe është publikuar në faqet e internetit të të dyja bankave. Për sa më sipër, aktivitetet e procesit të integritimit janë parashikuar të përfundojnë brenda datës 30.09.2018.

*Në lidhje me çështjen e parë*, të parashtruar nga Komisioneri, Intesa San Paolo Bank informon se sikurse shpjegohet edhe në Aneksin 1 – Raporti i Bashkimit të Grupit ISP për Shqipërinë, ISP Albania – Veneto Banca, pasojat e bashkimit për punonjësit e kësaj të fundit burojnë nga nenet 138, 139, 139/1 dhe 148 të Kodit të Punës. Bashkimi i dy bankave parashikon zbatimin e një plani ristrukturimi. Banka do të menaxhojë një plan të tillë ristrukturimi, vetëm për arsye ekonomike, teknike apo strukturore, në përputhje të plotë me ligjet në fuqi në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë (i) degët fizike të të dy bankave paraqesin një mbivendosje substanciale dhe bazohen në një model dhe profil biznesi të ngjashëm; (ii) drejtoritë qendrore paraqesin pothuajse të njëjtin konfigurim; (iii) gjendja financiare e Veneto Banca sh.a. konfirmon një rentabilitet strukturor negativ, që do të sillte një barrë ekonomike të paqëndrueshme për subjektin e ri; (v) ka dukshëm duplikime të sistemeve, faciliteteve, si dhe të burimeve të tjera, fizike dhe njerëzore.

*Lidhur me çështjen e dytë*, të parashtruar në shkresën e KMD-së, Banka Intesa San Paolo informon se ndikimi që do të ketë procesi i bashkimit apo shkrirjes së dy bankave është menaxhuar në përputhje të plotë me nenin 138/4 të Kodit të Punës të RSH-së, i cili duke iu referuar nenit 148 të Kodit të Punës, parashikon zbatimin e planit për pushimin kolektiv të

punonjësve. Banka Intesa San Paolo Albania ka respektuar të gjitha procedurat e parashikuara në Kodin e Punës, duke zhvilluar takime dhe konsultime të ndryshme me Këshillin e Punonjësve të Veneto Banca sh.a., duke filluar nga data 10.05.2018, deri më 18.06.2018, me qëllim zvogëlimin e ndikimeve ndaj punonjësve dhe arritjen e një marrëveshjeje.

Në mbledhjen e parë që u zhvillua në datën 10.05.2018, Banka Intesa San Paolo S.p.A, informoi Këshillin e Punonjësve të Veneto Banca sh.a se ka vlerësuar se nga 115 punonjës që rezultojnë në 31.03.2018, 78 persona do të ishin subjekt i “planit për pushimin kolektiv të punonjësve”, i cili do të aktivizohet menjëherë pas miratimit të “Planit të Bashkimit” nga autoritetet kompetente. Në datën 31.07.2018, nga 102 punonjës të Veneto Banca, numri i punonjësve që janë subjekt i pushimit kolektiv është zvogëluar në 36, pasi ISBA ka mbuluar 26 vende të lira me kolegët e Veneto Banca sh.a., të cilët kanë “kualifikim të krahasueshëm”, sikundër parashikohet në nenin 148/7 të Kodit të Punës. Megjithatë, duke patur parasysh që Punëdhënësi nuk arriti marrëveshje me Këshillin e Punonjësve, procesi i konsultimit vijoi më tej me ndërhyrjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Në datën 01.08.2018 është nënshkruar një marrëveshje ndërmjet 3 palëve (Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Këshilli i Punonjësve të Veneto Banca dhe Punëdhënësit), ku krahas dispozitave të Kodit të Punës, Punëdhënësi do t’i paguajë punonjësve një shumë bruto prej 9 pagash mujore, nëse punonjësit do të nënshkruajnë Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Kontratës së Punës.

Lidhur me çështjen e tretë, në shkresë theksohet fakti se Punëdhënësi<sup>5</sup> nuk ka dërguar asnjë letër njoftim për përfundimin e kontratës së punës ndaj punonjësve të Veneto Banca sh.a. dhe një letër e tillë nuk është dërguar as nga Intesa San Paolo Bank Albania sh.a., sepse kjo bankë është një subjekt tjetër që nuk ka asnjë fuqi kontrolli ndaj Veneto Banca.

*Lidhur me çështjen e katërt, në shkresë theksohet fakti se Banka Intesa San Paolo sh.a. nuk mund të sigurojë këtë informacion, pasi është një subjekt që e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në legjislacionin shqiptar dhe nuk ka qasje në informacion që lidhet me punonjësit e Veneto Banca.*

*Lidhur me çështjen e pestë dhe të gjashtë, Banka Intesa San Paolo shprehet se ajo e ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar dhe ky i fundit nuk e parashikon krijimin e Fondit të Solidaritetit. Ndërkohë që, nuk disponon informacion mbi përdorimin e këtij fondi në Itali.*

2. Në vijim strukturat përkatëse të KMD-së u vunë në kontakt me ankuesin dhe ky i fundit, nëpërmjet e-mailit të datës 24.09.2018, e njofton Komisionerin se para disa ditësh, ai dhe 35 punonjës të tjerë të Veneto Banca, janë vënë përpara dy zgjedhjeve. E para konsistonte

---

<sup>5</sup> Punëdhënësi konsiderohet Veneto Banca sh.a.

në njoftimin për zgjidhjen e kontratës së punës<sup>6</sup> dhe ndjekjen e procedurave ligjore dhe e dyta ishte Marrëveshja Reciproke për Përfundimin e Kontratës së Punës.

Ankuesi thekson faktin se duke qenë në kushtet e nevojës financiare, si dhe duke patur parasysh faktin se se ai ka marrë një kredi nga Veneto Banca, aktualisht Banka Intesa San Paolo, të cilën është duke e shlyer, ka zgjedhur të nënshkruajë Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Kontratës së Punës. Në datën 24.09.2018, ankuesi u paraqit pranë Komisionerit dhe depozitoi në cilësinë e provës Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënieve të Punës, të lidhur ndërmjet Veneto Banca sh.a.dhe Z. Englant E.C..

## **II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Z. Englant E.C. është punësuar pranë Bankës Italiane të Zhvillimit sh.a<sup>7</sup>, nëpërmjet kontratës së lidhur në datën 27.04.2006, në pozicionin e punonjësit të sekretarisë së Drejtorisë Qendrore të Bankës. Kjo kontratë është lidhur me afat të pacaktuar duke nisur nga data 08.05.2006. Në vijim, pozicioni aktual i punës së ankuesit është Specialist në Departamentin e Tregut dhe Produkteve pranë Veneto Banca. Nëpërmjet një e-maili të dërguar në datën 08.06.2018, nga ana e Këshillit të Punëmarrësve të Bankës Veneto, ankuesi vihet në dijeni të faktit se si rrjedhim i shkrirjes /bashkimit të Veneto Banca sh.a. me Bankën Intesa San Paolo Albania sh.a., rreth 43 punonjës të Bankës Veneto, janë bërë pjesë e një liste për t'u larguar nga puna. Në këtë listë rezultonte edhe emri i tij.

Proçesi i bashkimit ose shkrirjes së dy bankave të sipërpërmendura erdhi si rezultat miratimit të Projekt Bashkimit me përthithje të Veneto Banca sh.a. në Bankën Intesa San Paolo sh.a. në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Asamblesë së Veneto Banca sh.a dhe ISBA sh.a., në datën 04.05.2018. Veneto Banca sh.a. do të përthithej nga Banka Intesa San Paolo Albania sh.a., fakt i cili u miratua paraprakisht me Vendimin nr. 63, datë 01.11.2017, të Këshillit Mbikqyrës së Bankës së Shqipërisë, lidhur me blerjen 100% të kapitalit aksioner të Veneto Banca sh.a. nga Intesa San Paolo (ISP) SpA. Në datën 01.12.2017 është kryer regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) i transferimit të aksioneve të Veneto Banca në ISP SpA.

<sup>6</sup> Ky akt nuk u vu në dispozicion të KMD-së, pasi ankuesi ka nënshkruar marrëveshjen e dytë.

<sup>7</sup> Në vitin 2009, emërtesa e bankës ndryshoi në Veneto Banca.

Në këtë kuadër, bashkimi me përthithje passolli implementimin e një plani ristrukturimi, që pati si pasojë pushimin kolektiv të një pjese të punonjësve të Veneto Banca.

Në kuadër të zbatimit të pushimit kolektiv, si dhe mbështetur në pikën 8, të nenit 148, të Kodit të Punës, në datën 01.08.2018 është nënshkruar një Marrëveshje midis Punëdhënësit - Veneto Banca, Përfaqësuesve të Këshillit të Punonjësve të Veneto Banca dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e ndërmjetësuesit. Në këtë marrëveshje përcaktohen elemente të rëndësishme, për t'u mbajtur parasysh nga punëdhënësi gjatë procesit të zbatimit të pushimit kolektiv. Gjatë analizimit të saj, Komisioneri konstaton se *"Marrëveshja në lidhje me procesin e pushimit kolektiv për punonjësit e Veneto Banca nr. 1319 Rep, Nr. 546 Kol., datë 01.08.2018"* ka si palë të saj, Veneto Banca dhe jo Bankën Intesa San Paolo, subjekt kundër së cilës drejtohet ankesa e Z. E.C.. Në këtë Marrëveshje, në rolin e përfaqësuesve të punonjësve të kësaj banke është Këshilli i Punonjësve të Veneto Banca<sup>8</sup>.

Në të palët kanë rënë dakord mbi disa bonuse që do të përfitojnë punonjësit e Veneto Banca, të cilët do t'i nënshkrohen pushimit kolektiv. Në pikën 1, të Marrëveshjes në fjalë parashikohet se në referencë të nenit 148/7 të Kodit të Punës, punëdhënësi informon se ISBA (shoqëria përthithëse) ka formalizuar marrëveshje individuale për 26 punonjës që kanë "kualifikim të krahasueshëm" për të mbuluar 26 pozicione vakante të krijuara në Intesa San Paolo Albania sh.a. Njëkohësisht, në pikën 2 të Marrëveshjes, parashikohet paketa ekonomike për personat që do të jenë subjekt i pushimit kolektiv, ku përveç dëmshpërblimit për vjetërsi në punë dhe pagës gjatë periudhës së njoftimit, do t'u ofrohet edhe një pagesë prej 9 pagash mujore bruto duke marrë si referencë pagën e fundit të çdo punonjësi, pavarësisht nga vjetërsia në punë, me kusht që këta punonjës të firmosin "Marrëveshje Reciproke të Përfundimit të Marrëdhënies së Punës" me punëdhënësin. Në vijim parashikohen bonuse të tjera, të cilat përfshijnë të drejtën e punonjësit që i nënshtrohet pushimit kolektiv dhe nënshkruan marrëveshjen e sipërpërmendur që të aplikojë në rast shpalljeje pozicione pune vakante nga Banka Intesa San Paolo sh.a. Këta punonjës gëzojnë të drejtën e parashikuar në nenin 143/5 të Kodit të Punës. Në pikën 5, të marrëveshjes cilësohet se për punonjësit që janë subjekt i pushimit kolektiv dhe ata që do të nënshkruajnë Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës me Punëdhënësin, ISBA do të aplikojë për kreditë ekzistuese, termat dhe kushtet preferenciale, që aktualisht janë në fuqi për stafin në ISBA.

Në vijim të kësaj marrëveshjeje, rezulton se Z. E.C. ka nënshkruar me vullnetin e tij të lirë *"Marrëveshjen Reciproke për përfundimin e marrëdhënieve të tij të punës, datë 15.09.2018"*, e

<sup>8</sup> Në gjermën (E), të Marrëveshjes është përcaktuar se: *"Ministria ka njohur faktin se Këshilli përbën përfaqësuesin ligjor të punonjësve të Veneto Banca sh.a., në lidhje me nenet 139, paragrafi 1 dhe 148, paragrafi 2, të Kodit të Punës së Shqipërisë"*.

cila është lidhur ndërmjet tij dhe Veneto Banca. Në këtë të fundit përcaktohet se përfundimi i kontratës së punës dhe data e fundit e punës për punonjësin do të jetë data 19.10.2018. Referuar pikës 2 të kësaj marrëveshjeje, rezulton se mbështetur në kontratën e punës dhe *“Marrëveshjes në lidhje me procesin e pushimit kolektiv për punonjësit e Veneto Banca nr. 1319 Rep, Nr. 546 Kol., datë 01.08.2018”*, punëdhënësi bie dakord të paguajë për punonjësin, një dëmshpërblim, që përbën një pagesë të vetme në shumën bruto prej 1, 170, 000 (Pagesë për përfundimin e marrëdhënies së punës”). Kjo shumë ka si qëllim të mbulojë çdo lloj shpërblimi për shkak të përfundimit të marrëdhënies së punës. Përveç kësaj shume, Veneto Banca do t’i paguajë punonjësit: (1) pagën deri në datën e Përfundimit të Marrëdhënies së Punës sipas Kontratës së Punës; (2) pushimet vjetore të grumbulluara dhe të papërdorura; (3) periodha e njoftimit paraprak nga data 22.10.2018, deri më 13.12.2018 (Lek 230, 455); (4) shpërblimi për vjetërsi 6 paga bruto, i barabartë me shumën Lek 819, 534, si dhe çdo lloj shume tjetër sipas Kodit të Punës.

*“Marrëveshjet Reciproke për përfundimin e marrëdhënieve të tij të punës”* u janë ofruar për nënshkrim të gjithë punonjësve të Veneto Banca sh.a., që i janë nënshtruar pushimit kolektiv.

Në pikën 4, të *“Marrëveshjes Reciproke për përfundimin e marrëdhënieve të tij të punës, datë 15.09.2018”*, të lidhur ndërmjet ankuesit dhe Veneto Banca sh.a. përcaktohet shprehimisht: *“Punëdhënësi dhe Punonjësi, me pëlqim dypalësh, bien dakord për të ndërprerë Kontratën e Punës duke filluar nga data 19 Tetor 2018”*. Njëkohësisht, në pikën 12, paragrafi 2, përcaktohet: *“Gjithashtu, të dyja palët deklarojnë dhe bien dakord se do të heqin dorë nga e drejta për të ndjekur pretendimet që rezultojnë nga zgjidhja e Kontratës së Punës, nëpërmjet rrugës gjyqësore”*.

Referuar përmbajtjes së marrëveshjeve të mësipërme, Komisioneri gjykon si më poshtë:

Subjekti me të cilin ankuesi ka ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ka lidhur marrëveshjen e mësipërme, është Punëdhënësi i tij - Veneto Banca sh.a. Në fund të marrëveshjes përveç nënshkrimeve të punëdhënësit dhe punëmarrësit, ndodhet edhe nënshkrimi i përfaqësuesit të Bankës Intesa San Paolo Albania sh.a., në cilësinë e pranuesit dhe miratuesit. *“Marrëveshja Reciproke për përfundimin e marrëdhënieve të tij të punës, datë 15.09.2018”*, e lidhur ndërmjet ankuesit dhe Veneto Banca sh.a. konsiston në shprehjen e lirë të vullnetit ndërmjet dy palëve, mbi zgjidhjen e kontratës së punës, fakt që reflektohet shprehimisht në dispozitat e saj. Punëmarrësi ka pranuar kushtet e vëna nga Punëdhënësi i tij – Veneto Banca sh.a., me konsensusin e Bankës Intesa San Paolo Albania sh.a.. Në këtë mënyrë, ai ka rënë dakord mbi këto kushte dhe e ka nënshkruar këtë marrëveshje.



Duke qenë se nga ana e Veneto Banca janë zbatuar procedurat e parashikuara për pushimin kolektiv, si dhe në kushtet, kur kjo e fundit ka nënshkruar “*Marrëveshjen në lidhje me procesin e pushimit kolektiv për punonjësit e Veneto Banca nr. 1319 Rep, Nr. 546 Kol., datë 01.08.2018*” me Këshillin e Punonjësve të kësaj banke dhe kanë rënë dakord mbi një sërë elementësh që do ta shoqëronin pushimin kolektiv, të cilat janë reflektuar edhe në “*Marrëveshjet Reciproke për përfundimin e marrëdhënieve të punës*”, në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se ankuesi Englant E.C.j nuk i është ekspozuar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues, e të pabarabartë nga ana e Bankës Intesa San Paolo sh.a.

Në kushtet kur në “*Marrëveshjen në lidhje me procesin e pushimit kolektiv për punonjësit e Veneto Banca nr. 1319 Rep, Nr. 546 Kol., datë 01.08.2018*”, të nënshkruar ndërmjet Veneto Banca sh.a. dhe Këshillit të Punonjësve të kësaj banke, është parashikuar se për punonjësit që janë subjekt i pushimit kolektiv dhe ata që do të nënshkruajnë *Marrëveshjen Reciproke për Përfundimin e Marrëdhënieve të Punës* me Punëdhënësin, ISBA do të aplikojë për kreditë ekzistuese termat dhe kushtet preferenciale që aktualisht janë në fuqi për stafin në ISBA, kjo e fundit ka detyrimin e aplikimit të këtij parashikimi ndaj kredisë që ankuesi ka marrë gjatë kohës që ka punuar pranë Veneto Banca.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues, nuk ka diskriminim për shkaqet e pretenduara nga ankuesi.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 2, gërma c), nenin 7, pika 1, nenet 12-13, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të Z. E.C., për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”, nga ana e Bankës Intesa San Paolo Albania sh.a.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**

Fusha –punësim  
Shkak – perkatesia ne nje grup te vecante